



Task Forca për Integrim Evropian
Task Forca za Evropske Integracije
Task Force on European Integration

Tryeza Tematike

“Bujqësia, Zhvillimi Rural, Pylltaria, Peshkataria dhe Siguria e Ushqimit”

*Materiali Diskutues: PYLLTARIA*¹

Nëntor 2012

¹ Ky material diskutues është hartuar nga konsulenti i pavarur z. Qazim Kukulaj me mbështetjen e “Agjencisë Gjermane për Zhvillim Ndërkombëtar [*Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH*]”, përmes projektit “Përkrahja e procesit të integritit evropian në Kosovë”. Këndvështrimet, informatat dhe/ose argumentet nuk paraqesin domosdoshmërisht mendimin/qëndrimin zyrtar e të hollësishëm të GIZ, MIE dhe apo ndonjë pjesëmarrësi të TRT.

Përmbatja

PASQYRË E PËRGJITHSHME	3
1. Zhvillimi Kronologjik i Menaxhimit me Pyje në Kosovë.....	3
2. Resurset Pyjore.....	4
3 Krahësim i shkurtë i të dhënave të pyjeve dhe pylltarisë në Kosovë me të dhëna Evropiane	7
4. Politikat Pyjore dhe Strategjitë Zhvillimore Pyjore.....	7
4.1 Aktivitetet e ndërmarra nga institucionet përgjegjëse:.....	8
4.2 Dobësitë e Sektorit të Pylltarisë të konstatuar me Strategji.....	9
4.2. Politikat Pyjore – propozim aktivitetet dhe sfidat	9
4.3 Propozim i plotësimit të “ Dokumenti Politikat dhe Strategjia e Zhvillimit të Sektorit të Pylltarisë të Republikës së Kosovës, 2010- 2020”	10
4.3.1. Propozim i aktiviteve	11
5 Programi Pyjor	11
5.1 Aspekte të përgjithshme	11
5.2 Aktivitetet e ndërmarra	12
5.2.1. Pikat e dobëta të planifikimit menaxhues pyjor - propozimi për zgjidhjen e tyre.....	13
6. Legjislacioni Pyjor	13
6.1 Aktivitetet e ndërmarra nga MBPZHR	13
6.1.1. Ligjet bazë	14
6.1.2. Ligjet e ndërlidhura me pyjet dhe pylltarinë	14
6.2 Sfidat – Pikatë e dobëta	15
7. Aktet ligjore Ndërkombëtare.....	15
8. Strukturat administrative dhe menaxhuese të pyjeve, tokave pyjore dhe kafshëve të egra.....	16
8.1 Departamenti i Pylltarisë (DP).....	16
8.2 Agjencia Pyjore e Kosovë (APK).....	18
8.2.1 Struktura e APK-ës	18
8.2.2 Përgjegjësitë kryesore.....	18
8.2.3 Drejtoria për Silvikultur, Hulumtim dhe prodhim Fidanor (Instituti i Pyjeve të Kosovës)	19
9. Parimet e përgjithshme për Menaxhim të Qëndrueshëm të Pyjeve dhe Resurseve Pyjore.....	21

PASQYRË E PËRGJITHSHME

Kosova gjendet në pozitën qendrore të Pensilvanisë Ballkanike. Shtrihet në gjerësinë gjeografike veriore në mes të 41°50'58 "dhe 43° 51'42" dhe gjatësi gjeografike në mes të 20 ° 01'30" dhe 21°48'02". Sipërfaqja e Kosovës është rreth 10,887 km², me 1,739,825 milion banor² me dendësi rreth 160 banor/km². Republika e Kosovës kufizohet me: Shqipërinë në Jug- Perëndim, me Maqedoninë në Jug-Lindje, Serbinë në Lindje, Veri dhe Veri-lindje dhe me Malin e Zi në perëndim. Territori i Kosovës karakterizohet me masive pyjore si : Kopauniku dhe Rogozna në veri, në jug- prëndim Pyjet e Mokra Gora dhe Pyjet e Thata, në perëndim, Zhlebi, Hajla, Mokna, Bjeshkët e Nemuna (Alpet Shqiptare), në jugperëndim, Pashtriku, në jug, Koritniku, Pyjet e Jezercit, Nerodimja dhe Pyjet e Sharri. Në drejtim veri-jug të Kosovës qendrore shtrihen pyjet e Drenicës. Në lindje pyjet e Prugovcit, Koznica dhe Zhegovci. Të ndikuara nga faktorët klimatik, orografik, gjeologjik dhe pedologjik janë formuar këto bashkësi (Associazione) pyjore: Pyjet e dushkut (Quercetum farnetto-cerris Rud.), Pyjet e Ahut (Fagetum moesiacea scardicum Cras.), Pyjet e Ahut dhe Bredhit (Abieto Fagetum Jov.), Pyjet e Hormoqit (Picetum excelsae), Pyjet e Rrobullit (Pinion heldreichii), Pyjet e Pishes (Pinus sp.) dhe pyjet e Kërlekës (Pinion Mughii Pawl.)

1. Zhvillimi Kronologjik i Menaxhimit me Pyje në Kosovë

Menaxhimi me pyje dhe resurse pyjore të Kosovës gjatë historisë i është nënshtruar zhvillimit të sistemeve politike dhe shoqërore. Luftërat për gjatë historisë, konfliktet, krizat politike, ekonomike dhe sociale, kanë ndikuar në dëmtimin e pyjeve dhe resurseve pyjore deri në degradim të sipërfaqeve të tëra pyjore dhe resurseve tjera natyrore. Kërkesa e madhe për drurë për ndërtim pas luftës së Parë dhe të Dytë Botërore dhe Luftës së Fundit, si dhe nevoja shumë e madhe për drurë për ngrohje dhe nevoja tjera familjare, kanë bërë që gjendja e pyjeve në cilësi dhe sasi të tregojë trendë negativë në vazhdimësi. Nuk mund të përjashtohen edhe qëllime tjera të eksploatimit të pyjeve në territorin e Kosovës, posaçërisht pas Luftës së Dytë Botërore dhe gjatë dekadës së fundit të Shekullit 20-të. Mjerisht edhe pas vitit 1999 e gjerë më sot po vazhdon dëmtimi i pyjeve, kryesisht nëpërmjet prerjeve jo ligjore, zjarreve pyjore, sëmundjeve dhe dëmtuesve pyjor, dëmtim të tokës pyjore, dëmtim të faunës dhe florës, duke përfshirë edhe lloje të rralla dhe të rrezikuara të florës dhe faunës.

Mungesa e stafit në numër dhe kompetencë (njohuri dhe dituri) është faktor shtesë që e ka përcjellë këtë sektor dhe po vazhdon edhe në ditët e sotme. Rëndësia ekonomike, sociale dhe mjedisore për kohë të gjatë e deri në ditët e sotme nuk është kuptuar mjaftueshëm nga qeveritë dhe shoqëria në tërësi. Nga viti 2000 e deri më sot sektori i pylltarisë është mbështetur nga donator të jashtëm, duke filluar nga investime materiale (faza emergjente), ngritjen e kapaciteteve humane, themelimin e strukturave menaxhuese dhe organizative, hartimin e kornizës ligjore dhe strategjike e deri te mbështetja në planifikimin menaxhues të pyjeve dhe përafrimin e koncepteve menaxhuese me *Acquis Communautaire*. Kjo mbështetje me siguri do të rezultojë me përmirësimin e praktikave menaxhues dhe kornizës ligjore.

² Burimi: *Regjistrimi i Popullësisë, Ekonomive Familjare dhe Basnesave në Kosovë, 2011*

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) nëpërmjet Agjencisë Pyjore të Kosovës (APK) dhe Departamentit të Pylltarisë (DP.), në vazhdimësi ka zhvilluar aktivitete në drejtim të përmirësimit të strukturës organizative, strukturës të menaxhimit me Pyje dhe toka pyjore dhe kafshë të Egra, duke prodhuar (hartuar) akte ligjore dhe nënligjore, strategji dhe plane. Gjithashtu gjatë kësaj kohe janë pyllëzuar sipërfaqe të mëdha pyjore. Suksesi i pyllëzimeve është temë i cila meriton qasje më serioze. Përveç tjerash është themeluar Bordi i Menaxhimit me Pyje, janë themeluar disa Shoqata të Pronarëve të Pyjeve Private dhe janë hartuar disa plane menaxhuese (plane dhjetëvjeçare).

2. Resurset Pyjore³

Gjatë viteve 2003- 2004, është kryer Inventarizimi i pyjeve të Kosovës. Të dhënat e përgjithshme nga ky inventarizim mund të përmbledhen si në vazhdim:

- Sipërfaqja e përgjithshme e pyjeve dhe tokave pyjore është llogaritur të jetë rreth 464 800 hektar ose 42.69% e sipërfaqes së përgjithshme të territorit të Kosovës dhe rreth 0.27 hektar për një banor (per capita). Kjo mesatare është nën nivelin e mesatares në Evropë e cila është 1.26 ha për kokë banori⁴
- Sipërfaqja e pyjeve publike (Shtetërore), 278 880 ha ose 60% dhe
- Pyje private 185 920 hektar ose 40%.
- Sipërfaqja e llogaritur prej 464 800 hektarësh është më e madhe për rreth 8 % nga shënimet e përdorura në të kaluarën, 428.000 ha. Kjo është e kuptueshme pas parasysh lënien djerrin të kullotave dhe livadheve të cilat në të kaluarën janë kositur apo i janë nënshtruar kullotjes intensive nga bagëtitë e zonave të thella rurale. Migrimi i popullatës nga këto zona dhe mbetja djerr e kullotave dhe livadheve ka shkaktuar ndërrimin e kulturës, nga ajo bujqësore në pyje, nëpërmjet të regjenerimit natyral (mbirja e filizave nga farërat të ardhura nga drurët për rreth);
- Struktura pyjore është e dominuar nga pyjet gjetherënëse (fletor), me rreth 90% kryesisht me dominim të pyjeve të Ahut dhe Dushkut.
- Pyjet Halor mbulojnë rreth 7% të sipërfaqes së përgjithshme të pyjeve të dominuar kryesisht nga llojet e Bredhit dhe Hormoqit dhe me rreth 3% marrin pjesë llojet tjera të fletorëve dhe halorëve;
- Vëllimi total i pyjeve publike është llogaritur të jetë 33.5 milion metra kub (mil. m³), nga e cila masë vëllimi prej 25.9 mil.m³, përfshin vëllimin e drurëve me diametër më të madh se 7 cm. Vëllimi i përgjithshëm i pyjeve private është rreth 19.5 mil. m³ nga i cili, vëllimi prej 14.5 mil. m³ përfshin drurët me trashësi mbi 7 cm;
- Shtimi (rritja) vjetore e pyjeve sipas Inventarit të Pyjeve ka rezultuar të jetë 1.3 mil.m³/vjet.
- Shtimi vjetor (rritja vjetore) e pyjeve në trashësi dhe lartësi, respektivisht e vëllimit për hektar dhe shtimi në total janë me rendësi të veçantë në aplikimin e formave menaxhuese të pyjeve, planifikimin e shfrytëzimit pyjor vjetor dhe plotësimin e

³**Burimi:** *Inventarizimi i Pyjeve të Kosovës, 2003/2004*

⁴ **Source:** *UNECE, MCPFE &FAO, 2007, State of Europe's Forests 2007*

nevojave të popullatës, pa dëmtuar parimin e vazhdimësisë (menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve).



- Sipërfaqja e zhveshur pyjore sillet prej 20 000 – 30 000 ha. Disa prej këtyre sipërfaqeve janë të shtrira në toka të mira, (toka të pëlleshme) kurse disa prej tyre shtrihen në toka të cektë dhe jo pjellore.
- *Ndarja dhe evidentimi i sipërfaqeve sipas cilësisë së tokave dhe llojeve të tokave është e nevojshme dhe mundëson planifikimin real të pyllëzimit dhe zgjedhjes të llojeve përkatëse të fidanëve për pyllëzim. Duhet theksuar se një ndarje e tillë është e nevojshme të bëhet me inventarizimin e pyjeve i cili është në rrjedha e sipër dhe sipas të gjitha gjasave do të përfundoj këtë vit. .*
- Prezenca e prerjeve ilegale është e shtrirë në rreth 40% në pyjet publike dhe 29% në pyjet private⁵
- Sipas të gjitha standardeve të dhënat mbi sasinë e prerjeve ilegale (joligjore) janë shumë të mëdha. Gjendja në pyjet e halorëve sa u përket prerjeve dhe dëmtimeve joligjore është edhe më e keqe për shkak të vlerës më të madhe për metër kub, të asortimentit (prodhimit) drunor .Sugjerohet që të ndermirën aktivitete urgjente për minimizimin e veprimeve joligjore dhe me pasoja afatgjatë. Sugjerohët aplikimi i luftimit të shkaqeve në vend të masave të luftimit gjendjes me masa ekzekutive. Gjithashtu edhe pyjet e ultë (cungishte) në pronësi publike i janë ekspozuar prerjeve të pa kontrolluara në masë të madhe .

Në vazhdim është paraqitur pasqyra e strukturës së resurseve natyrore , struktura e pronësisë së pyjeve, dhe struktura e llojeve të pyjeve sipas origjinës.


Grafiku 1. Struktura e tokës

Grafiku 2. Struktura e pronësisë pyjore

⁵ **Burimi:** *Policy and Strategy Paper on Fforestry Sector Development 2010 – 2020, faqe, 15*



Grafiku 3. Struktura pyjore sipas origjinës



3 Krahasim i shkurtë i të dhënave të pyjeve dhe pylltarisë në Kosovë me të dhëna Evropiane

- Mesatarja e mbulesës pyjore me pyje në Evropë rreth është rreth 44%;
- Mbulesa pyjore në Kosovë është rreth 42.69%;
- Sipërfaqet pyjore në Evropë janë shtuar 15 vjetët e fundit;
- Sipërfaqet pyjore gjithashtu janë shtuar në Kosovë, 13-të vjetët e fundit për rreth 8%;
- Vëllimi i përgjithshëm i pyjeve është shtuar në Evropë për rreth 358 mil.m³;
- Vëllimi i përgjithshëm i pyjeve të Kosovës i llogaritur prej 53⁶ mil. m³ , është rritur krahasuar me 30.4⁷ mil.m në vitin 1979 ;
- Pyjet e Evropës janë të mbuluara me plane menaxhuese rreth 90%;
- Pyjet e Kosovës janë të mbuluara me plane menaxhuese rreth 20%⁸
- Sipërfaqja e Pyjeve Mbrojtëse në Evropë, gjatë pesë viteve të fundit është shtuar për rreth 5%;
- Sipërfaqja e Pyjeve Mbrojtëse në Kosovë ende nuk është futur si kategori menaxhuese e pyjeve, edhe pse përmendet vetëm si kategori ligjore pyjore në Projektligjin për Pyjet;
- Pyjet janë në pronësi publike në rreth gjysmën e Shteteve Evropiane kurse në përqindje të madhe në pronësi private në gjysmën tjetër të Shteteve Evropiane;
- Në Kosovë, pyjet janë pronësi publike me afro 60% dhe në pronësi private me rreth 40%
- Participimi i publikut në vendim marrje në shtetet Evropiane është rritur;
- Participimi i publikut në vendim marrje në Kosovë ka filluar.

4. Politikat Pyjore dhe Strategjitë Zhvillimore Pyjore

Çdo vend duhet të ketë “politikën” e tij pyjore me qëllim të përdorimit të pyjeve në dobi të njeriut. Hapi i parë në hartimin e politikave pyjore është identifikimi i mundësive dhe formulimi i propozimeve, si proces i vazhdueshëm, i përcaktuar për ta ruajtur balansin në mes të resurseve pyjore si furnizues potencial, në njërin anë dhe plotësues i nevojave të ndryshme të shoqërisë si konsumator, në anën tjetër. Ekziston koordinim shumë i ngushtë ndërmjet politikës pyjore dhe politikave të sektorëve tjerë, të cilat ndikojnë ose janë të ndikuara nga pylltaria, siç janë: Politikat Bujqësore, mjedisi, zhvillimi rural, industria, turizmi dhe punësimi.

⁶ **Burimi:** Inventarizimi i Pyjeve të Kosovës, , FAO, 2002/2003

⁷ **Burimi:** *uimarska Enciklopedija* , 20.10.1983, Fq..290,

⁸ Sippor to forest management planin with GIS, February, 2012

4.1 Aktivitetet e ndërmarrja nga institucionet përgjegjëse:

Prioritetet politike të Zhvillimit Ekonomik të Kosovës janë precizuar në Programin Qeveritar, 2011-2014, miratuar në Prill të vitit 2011. Në kontekst të shtyllës së I-rë të këtij Programi- “ Rritja dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm Ekonomikë” ndërlidhet edhe objektiva e përgjithshme e menaxhimit të pyjeve e cila konsiston, në shtimin e kontributit të sektorit të pylltarisë në ekonomin nacionale dhe shtimin e rolit social dhe mjedisor të pyjeve. Përqindja prej 42% e pjesëmarrjes së pyjeve në sipërfaqen e përgjithshme të Kosovës, kushtet klimatike dhe gjeologjike ofrojnë mundësin që ky sektor të marr pjesë në BPV të vendit prej 4%-8%⁹ në vend të pjesëmarrjes së tanishme prej 2.5%-3.5%.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Departamenti i Pylltarisë (DP) dhe Agjencia Pyjore e Kosovës (APK), kanë hartuar dokumente dhe Strategji Zhvillimore në të cilat është përfshirë edhe zhvillimi i sektorit të Pylltarisë. Dokumentet kryesore të miratuara janë:

1. “ Libri i Gjelbër”, Maj 2003, “ ;
2. Plani Zhvillimor Bujqësor dhe Rural 2007-2013;
3. Plani Zhvillimor Bujqësor dhe Rural 2009-2013;
4. Plani Zhvillimor Bujqësor dhe Rural, 2010- 2013;
5. Strategjia e Menaxhimit të Kafshëve të Egra në Kosovë, 21.10.2003 dhe
6. Dokumenti Politikat dhe Strategjia e Zhvillimit të Sektorit të Pylltarisë së Republikës të Kosovës, 2010-2020.

Dokumente e lartë shkruara janë hartuar nga MBPZHR- APK dhe DP, në mbështetje financiare dhe ofrim të ekspertizës nga organizata Qeveritare dhe Jo-qeveritare të shteteve të ndryshme.

Dokumente strategjike zhvillimore nga numri 1-4, kanë trajtuar pjesërisht zhvillimin e sektorit të Pylltarisë, gjë që nënkuptohet nga vetë titulli i këtyre dokumenteve, ku fokusi kryesor ka qenë caktimi i kaheve zhvillimore afatgjata të sektorit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe përpjekja e përafrimit të zhvillimit të këtyre sektorëve me BE dhe *Acquis Communautaire*. Kahjet dhe synimet afatgjatë të zhvillimit të Pylltarisë dhe menaxhimit me kafshë të egra, janë paraqitur dhe analizuar në mënyrë më detale në strategjitë, shënuar me numër 5 dhe 6.

Dokumenti Politikat dhe Strategjia e Zhvillimit të Pylltarisë së Republikës së Kosovës, 2010-2020 ka analizuar rolin e Qeverisë së Kosovës në zhvillimin e këtij sektori me theks të veçantë në rendësin e kuptimit të rolit ekonomikë, social dhe mjedisor të këtij sektori, për të vazhduar analizën e zhvillimit dhe përforcimit të kornizës institucionale dhe rregullative, zhvillimin e menaxhimit modern të pyjeve dhe tokës pyjore, konsolidimin e tokave pyjore, menaxhimin e zonave të mbrojtura, bashkëpunimin me

⁹ **Burimi:** *Policy and Strategy Paper on Fforestry Sector Development 2010 – 2020, faqe, 9*

ministri të linjës dhe bashkëpunimin ndër-sektorial e çështje tjera. Përveç tjerash “ Strategjia e Pylltarisë”, numëron një varg dobësish të konstatuara në sektorin e pylltarisë disa prej të cilave janë paraqitur në vazhdim..

4.2 Dobësitë e Sektorit të Pylltarisë¹⁰ të konstatuar me Strategji

Institucioni kryesor përgjigjes për çështje të pylltarisë (KFA) respektivisht APK, është themeluar me rregulloren e UNMIK-ut në vitin 2000 si Autoriteti Pyjore i Kosovës dhe është transformuar në Agjencia Pyjore e Kosovës (APK) më 2003, dhe ende mbetet institucion i dobët(**citati i përkthyer në shqip nga anglishtja**). Në vazhdim jepet arsyetimi i këtij konstatimi duke i përmendur shkaqet si:

“ Kompetenca e stafit, mungesa e fondeve dhe resurseve, mandatet (përgjegjësit) dhe rolet jo të qarta, planifikimi jo përkatës (jo adekuat) si dhe kontrolli dhe mbikëqyrja jo përkatëse. Sipas këtij dokumenti, dobësitë e numëruara do të prodhojnë:

1. Mungesën e mbledhjes së të hyrave sub-optimale nga shitja e masës drunore (prodhimeve drunore),
2. Lejet për prerje në disa raste bazohen në kritere informale,
3. Tregu u drurëve nuk është plotësisht transparent i cili nuk promovon treg eficient dhe biznes të shëndosh;
4. Jo shfrytëzimi i mbetjeve drunore, posaçërisht aty ku ndodhin prerjet ilegale;
5. Menaxhimi i pyjeve nuk zhvillohet në mënyrë konsistence duke çuar në zvogëlim të produktivitetit dhe zvogëlim të vlerës së trungjeve në këmbë dhe
6. Pyjet nuk janë mbrojtur nga zjarret, sëmundjet dhe dëmtuesit.

Edhe përkundër këtyre konstatimeve duhet theksuar se APK dhe DP, kanë ndërmarr disa aktivitete përkitazi me përmirësimin e menaxhimit me pyje dhe toka pyjore, duke përfshirë zbatimin e projektit për pastrimin e pyjeve dhe prerjeve fitosanitare, ngritjen e kapaciteteve nëpërmjet projektit të Binjakëzimit, hartimit e planeve menaxhuese mbështetur nga Norwegian Forestry Group (NFG), Fuqizimi i Qëndrueshëm i Pylltarisë së Decentralizuar e Private - SNV/SNVP, Zhvillimin e kapaciteteve njerëzore dhe përafrimin e kornizës legjislative të menaxhimit me pyje dhe toka pyjore mbështetur nga BE me projektin “ Binjakëzimi”, Certifikimi i Pyjeve –USAID, Eksplorimin e prodhimit dhe të shfrytëzimit të Biomassës dhe pagesës për shërbime mjedisore pyjore (PES) – BB/SNVP e projekte tjera të mbështetura nga FAO dhe SID-a, Suedeze.

4.2. Politikat Pyjore – propozim aktivitetet dhe sfidat

Në Kosovë ende mungojnë politikat konkrete pyjore në këto segmente:

¹⁰ Burimi: *Policy and Strategy Paper on Forestry Sector Development 2010 – 2020, faqe, 10*

- Caktimi i politikave të privatizimit të pyjeve (Denacionalizimi, restituimi apo ndonjë formë tjetër).
- Caktimi i përqindjes së synuar të pronës dhe pronësisë në Kosovë dhe mjetet për arritjen e qëllimit, duke përfshirë kohën dhe koston;
- Caktimi i politikave zhvillimore të edukimit dhe trajnimeve në Pylltari, (koha dhe kostoja);
- Caktimi i politikave pyjore, përkitazi me ndarjen e pyjeve sipas rëndësisë : Pyje ekonomike, pyje mbojtëse, rezervate pyjore (lloji i rezervateve), dhe caktimi i përqindjes së Zonave të Mbrojtura Natyrore në Kosovë duke specifikuar: Sipërfaqen e tërësishme, rajonet, dhe kohën e implementimit;
- Caktimi i politikave për menaxhimin e kafshëve të Egra dhe Shpendëve – caktimi i numrit optimal të llojeve të faunës së egër dhe kostoja e realizimit të politikës;
- Caktimi i metodës së trajtimit të tipave pyjore të caktuara dhe periudha e arritjes së objektivit;
- Rritja (shtimi) mesatar pyjor i synuar në nivel Vendi (Masat për arritjen e objektivës, koha dhe kostoja);
- Sipërfaqja e përgjithshme për pyllëzim në periudhën dhjetë vjeçare (lloji i pyllëzimeve, lloji i fidanëve dhe kostoja e përgjithshme);
- Zhvillimi i infrastrukturës pyjore të synuar, (përqindja e mbritshmërisë pyjore), për periudhën dhjetëvjeçare (lloji i infrastrukturës, numri i metrave për hektar (m/ha) dhe kostoja);
- Planifikimi dhjetëvjeçar i mbrojtjes së pyjeve nga sëmundjet dhe dëmtuesit pyjor (inventarizimi i sëmundjeve, sipërfaqja që do të përfshihet dhe propozim masat duke përfshirë koston e përgjithshme);
- Certifikimi pyjor- synimi, duke precizuar sipërfaqen e synuar për certifikim, kohën dhe objektivin;
- Përafrimi i kornizës ligjore dhe standardeve të menaxhimit të pyjeve me standardet e BE dhe Acquis Communaitare në sektorin e Pylltarisë - koha dhe kostoja;
- Caktimi i pjesëmarrjes së synuar të pyjeve në përqindjen e Energjisë së Ripërtërishme dhe sekuestrimin (stokimin) e CO₂ dhe
- Integrimi i strategjive zhvillimore të shfrytëzimit të pyjeve me Industrinë përpunuese të Drurit, duke e ruajtur bilancin ekologjik dhe biologjik të pyjeve.

Caktimi i objektivave të Politikës Zhvillimore Pyjore do të ndihmonte në zhvillimin strategjik të këtij sektori dhe ndalimin e veprimeve dhe aktiviteteve ad- hoc.

4.3 Propozim i plotësimit të “ Dokumenti Politikat dhe Strategjia e Zhvillimit të Sektorit të Pylltarisë të Republikës së Kosovës, 2010- 2020”

Në bazë të analizës të dokumentit në fjalë e me qëllim të lehtësimit të zbatimit të së njëjtit dokument, po jap disa vështrime dhe analiza përkitazi me aktivitetet që duhet ndërmarrë në plotësimin e këtij dokumenti, paraqitur në vazhdim:

4.3.1. Propozim i aktiviteteve

Përcaktimi i përdorimit shumë dimenzional, ekonomik, social dhe mjedisor të pyjeve trungishte (pyjeve të larta), bazuar kryesisht në gjenerimin natyral të pyjeve njëmoshorë dhe shumë mohorë, duke e caktuar sipërfaqen, kohën dhe koston e aktiviteteve. Caktimi i vendit, Njësisë Menaxhuese, Klasës Menaxhuese, Parcelës dhe Nën-parcelës e elemente tjerë. Kto duhet caktuar me **Plane afatgjatë dhe plane vjetore të menaxhimit të pyjeve dhe tokave pyjore**. Në vazhdim janë prezantuar disa prej synimeve të cilat është dashur të definojnë me dokumentin në fjalë si:

1. Caktimi i strategjisë të trajtimit të pyjeve cungishte cilësore, bazuar kryesisht në konvertime nga pyje të ulëta (cungishte) në pyje të larta (trungishte), duke caktuar sipërfaqen e përgjithshme në nivel Kosove, kohën dhe koston e aktiviteteve.
2. Planifikimi strategjikë i trajtimit të pyjeve cungishte me cilësi të dobët, duke aplikuar prerre rrah, trajtime rehabilituese pyjore (rrallime me standarde dhe ndërrimin e llojit drunor), duke caktuar sipërfaqen e përgjithshme në nivel Kosove, kohën dhe koston e aktiviteteve.
3. Planifikimi strategjikë i synuar të mbrojtjes së pyjeve nga burime të ndryshme të degradimit;
4. Planifikimi strategjikë i synuar i menaxhimit të pyjeve private (hartimin e planeve menaxhuese dhe zhvillimin e shërbimeve këshillimore dhe teknike,
5. Planifikimi strategjikë i synuar në aplikimin e skemave mbështetëse (subvencione dhe grande) për pronarët e pyjeve privat dhe përpunuesit e materialit të biomasës (ashkla, pelete dhe briket);
6. Përafrimin e menaxhimit të pyjeve në përputhje me direktivat Evropiane, me theks të veçantë në zbutjen e efekteve “ Sere” dhe ndikimeve të ndryshimeve klimatike, duke ju referua direktivave të Komisionit dhe Këshillit të Evropës si dhe konventave dhe marrëveshjeve rajonale dhe Botërore dhe
7. Caktimin e parametrave konkretë për balancimin e rritjes vjetore të pyjeve me shfrytëzim dhe plotësim të nevojave të popullatës, duke specifikuar në mënyrë të përgjithshme balancën në mes të ofertës, nevojës dhe mundësive të shfrytëzimit të pyjeve (MVSHP), për zbutjen e dis-balancit në mes të nevojave dhe ofertës etj.

5 Programi Pyjor

5.1 Aspekte të përgjithshme

Forma e menaxhimit me pyje Shtetërore (Publike) të Kosovës duhet të definohet me **Plane Menaxhuese Pyjore** të cilat zakonisht kanë afatin e vlefshmërisë prej dhjet vjetësh. Ato përshkruajnë menaxhimin afate-gjatë të pyjeve në aspektin kohorë dhe hapësinor dhe paraqesin kushtet dhe objektivat e menaxhimit të pyjeve dhe tokave pyjore. Planet menaxhuese përcaktojnë rritjen (shtimin) optimale të pyjeve, rritjen vjetore, shfrytëzimin e pyjeve dhe format e shfrytëzimit, sipërfaqet që do të pyllëzohen

dhe lloji i pyllëzimeve (pyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura, pyllëzime melioruese, ripyllëzime) si dhe përcaktojnë parcelat, llojin e fidanëve, numrin e fidanëve për hektar etj. Përmbajtja e planeve menaxhuese dhe caktimi i objektivave duhet të jenë në përputhje me Politikën Pyjore dhe Strategjinë Zhvillimore të Menaxhimit me Pyje.

5.2 Aktivitetet e ndërmarra

Autoriteti Pyjor i Kosovës ka kryer Inventarizimin Nacional të Pyjeve në vitin, 2002/2003, mbështetur nga Organizata Botërore për Ushqim e Bujqësi (FAO). Më vonë ka filluar me hartimin e planeve menaxhuese nga mjetet e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe NFG (Norwegian Forestry Group).

Disa të dhëna¹¹ tregojnë se deri më tani janë hartuar planet menaxhuese për 21 njësi menaxhuese të cilat mbulojnë afro 92000 hektar apo 20% nga sipërfaqja e përgjithshme pyjore e Kosovës. Sipërfaqja pyjore e mbuluar me plane menaxhuese e pyjeve të larta është rreth 28 688 hektar me vëllim të llogaritur prej 6 235 266 m³ dhe vëllim mesatar prej afro 217.30 m³. Shtimi (rritja) e përgjithshme vjetore shprehur në m³/vjet është llogaritur të jetë 188 4999. Mesatarja e prerjeve jo –ligjore (ilegale), gjithnjë sipas dokumentit të referuar, shprehur në përqindje të shtimit (rritjes) vjetor është llogaritur të jetë 56%. Kjo përqindje parqet sfidë të madhe dhe shqetësim për institucionet përgjegjëse, siç është shprehur edhe në dokumentin strategjik e dokumente tjera.

Agjencia Pyjore e Kosovës, gjithashtu është në zbatimin të Inventarizimit të dytë të pyjeve në nivel të Kosovës. Të dhëna nga inventarizimi i pyjeve në zbatim e sipër nuk kemi muajt të sigurojmë meqenëse punët janë në zhvillim e sipër. Vlen të theksohet se SNV/SNVP në kuadër të projektit: “*Fuqizimi i Qëndrueshëm i Pylltarisë së Decentralizuar e Private*” ka hartuar disa plane menaxhuese për pyje private dhe për pyje publike, kryesisht pyje të reja dhe pyje të degraduara të formës “cungishte”. Trajtimit të kësaj kategorie pyjore nuk i është dhënë tretman i duhur në planet menaxhues të prodhuara deri me tani edhe përkundër pjesëmarrjes shumë të madhe të këtyre pyjeve në sipërfaqen e përgjithshme pyjore të Republikës së Kosovës. Bazuar nëp kët fakt, SNVP, përpos aktiviteteve tjera sipas ToR, është në zhvillim të aktiviteteve për harmonizimin e metodologjisë dhe formës më të përshtatshme të hartimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të planeve menaxhuese dhe promovimin e rednësisë së kësaj kategorie pyjore. Me mbështetje të SID-a, dhe propozim të DP dhe APK-ës janë hartuar nga SIPU i Suedisë dy projekt propozime:

- Trajtim Silvikulturor i Pyjeve të Reja në Kosovë dhe
- Themelimi i Qendrës Trajnuese Pyjore.

Duhet theksuar se në mbështetje të NFG është themeluar qendra e të dhënave , pyjore (FisKos) në Shtator 2012. Duke mos u futur në detale dhe analiza, jam i mendimit se përkitazi me planifikimin menaxhues (qeverisës) pyjor duhet zhvilluar këto aktivitete dhe evituar dobësitë e evidentuara, disa prej të cilave po i theksojmë në vazhdim:

¹¹ Burimi: *Mbështetja e planifikimit të menaxhimit me GI- , NFG, Shkurt, 2012.*

5.2.1. Pikat e dobëta të planifikimit menaxhues pyjor - propozimi për zgjidhjen e tyre:

- Mungesa e koherencës në relacion planifikimi menaxhues me politikat dhe strategjitë pyjore. **Zgjidhja:** Harmonizimi i metodologjisë dhe synimeve të caktuar në trajtimin e kategorive të ndryshme të pyjeve me politikat dhe dokumentet strategjike pyjore;
- Përpunimi i shënimeve jashtë Kosovës dhe mos prezenca e stafit Kosovar gjatë përpunimit të shënimeve. **Zgjidhja :** Kyçja e stafit Vendor në përpunimin e shënimeve dhe dizajnimin e planeve menaxhuese;
- Sfidat në zbatimin praktik të planeve menaxhuese. **Zgjidhja:** Trajnim i stafit zbatues në interpretimin e planeve menaxhuese
- Mungesa e tabelave vendore të prodhimit dhe tabelave të produktivitetit. **Zgjidhja:** Investim në punimin e tabelave të prodhimit dhe produktivitetit për pyjet e Kosovës
- Jo kompletimi i kodifikimit pyjor të Kosovës. **Zgjidhja:** Hartimi i kodit të ri për pyjet e Kosovës dhe harmonizimi me kodin ekzistues
- Jo përcaktimi i të gjitha kategorive pyjore me plane menaxhuese. **Zgjidhja:** Përcaktimi ligjor dhe teknik i kategorive pyjore dhe qëllimi i tyre etj.

6. Legjislacioni Pyjor

6.1 Aktivitetet e ndërmarra nga MBPZHR

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, respektivisht DP. dhe APK, në bashkëpunim dhe koordinim në mes të konsulentëve vendor dhe konsulentëve ndërkombëtar ka hartuar Ligjin për Pyjet e Kosovës 2003/3 dhe ka bërë dy amandamentime të këtij Ligji. Vlen të theksohet se Ligji në fjalë është ligji i par i aprovuar nga Kuvendi i Kosovës në kuadër të MBPZHR. Këtë vit institucionet e lartpërmendura , në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare, të cilat mbështesin sektorin e Pylltarisë në Kosovë, kanë hartuar Draft Ligjin për Pyjet e Kosovës. I njëjti është miratuar nga Qeveria dhe është proceduar në Kuvendin e Kosovës, për miratim. Gjithashtu institucionet përgjegjëse për menaxhim të pyjeve dhe tokave pyjore dhe menaxhim të kafshëve të egra dhe gjuetisë, kanë hartuar dhe miratuar deri më tash, 38 udhëzime administrative, tri prej të cilave janë shfuqizuara.

Ligji për Pyjet e Kosovës Nr. 2003/3, përveç tjerash ka rregulluar administrimin dhe menaxhimin e pyjeve dhe tokave pyjore si dhe rregullimin e menaxhimit të pyjeve private dhe pyjeve në Parqet Kombëtare. Me këtë Ligj janë rregulluar edhe çështjet tjera si: E drejta për shfrytëzimin e pyjeve, dhënies me qira e tokës pyjore, e drejta e pronës mbi pyje, struktura organizative dhe menaxhuese e administrimit dhe menaxhimit të pyjeve dhe tokave pyjore, hartimi i planeve menaxhuese dhe planeve vjetore, shfrytëzimi i produkteve pyjore drunore dhe jo-drunore, mbrojtja nga zjarri, mbrojtja nga njeriu,

mbrojtja nga sëmundjet dhe dëmtuesit, funksioni i organeve për mbrojtjen e pyjeve (Inspekcioni dhe Rojet e pyjeve) si dhe janë përcaktuar ndëshkimet për shkeljet dhe menaxhimin joligjor të pyjeve dhe tokave pyjore. Vlen të veçohet obligimi me këtë ligj, i menaxhimit me pyje në pajtim me deklaratën e parimeve për konsensusin global mbi menaxhimin, ruajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të gjitha pyjeve të dhëna në aneksin III të raportit të Konferencës së Kombeve të Bashkuara mbi Mjedisin dhe Zhvillimin (Rio de Zheneiro, 3-14 qershor, 1992), duke respektuar këto parime:

- Parimi parandalues,
- Konservimi i diversitetit biologjik;
- Parimi i barazisë ndër njerëzore dhe
- Zhvillimi ekologjik i qëndrueshëm.

Në vazhdim është paraqitur lista e akteve kryesore ligjore për rregullimin e menaxhimit dhe administrimit të pyjeve dhe tokave pyjore dhe akteve ligjore të ndërlidhura me pyjet dhe tokën pyjore.

6.1.1. Ligjet bazë:

- Ligji për Pyjet e Kosovës, 2003/3;
- Amandamenti i Ligjit për Pyjet, 2004/29;
- Amandamenti i Ligjit për Pyjet 2005/49;
- Ligji për Gjueti 2005/02- L – 53

6.1.2. Ligjet e ndërlidhura me pyjet dhe pylltarinë

1. Ligji i Ndikimit në Mjedis 2010/03 –L -214;
2. Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit 2009/03-L-025;
3. Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale 2008/03/2004;
4. Ligji mbi Mbrojtjen e Natyrës 2010/03/-I-233;
5. Ligjit mbi Zonat e Veçanta Mbrojtëse, 2008/03- L- 039;
6. Ligji mbi Vlerësimin Strategjik Mjedisor, 2010/03 –L- 230;
7. Ligji mbi Mbrojtjen nga Zjarri 2006/02- L41;
8. Ligji mbi Minierat dhe Mineralet 10/ 03/-L- 163;
9. Ligji për Materialin Fidanor 2004/13
10. Ligji për Ujërat e Kosovës 2004/24 dhe
11. Ligji për rregullimin e Tokës 2011/04-L- 040 etj

6.2 Sfidat – Pikatë e dobëta

- Transparençë jo e mjaftueshme gjatë hartimit të ligjeve dhe akteve nën ligjore.

Zgjidhja: Kyçja e të gjithë palëve të interesuar në të gjitha fazat e hartimit dhe zbatimit të Ligjit

- Mungesë e analizimit dhe kuptimit të akteve ligjore të BE-së. **Zgjidhja:**

Angazhimi i personave me njohuri dhe përvojë të mjaftueshme gjatë hartimit të ligjeve

Duhet pranuar faktin se Bashkimi Evropian ka hartuar numër të limituar të akteve ligjore të cilat janë drejtpërsëdrejti të ndërlidhura me pyjet dhe se shumica e akteve ligjore të BE-së, rolin dhe rregullimin e pyjeve e trajtojnë në kuadër të direktivave për çështje mjedisore.

- Reflektim i subjektivitetit të përfaqësuesve të ministrive të linjës dhe përfaqësuesve të njësisë organizative brenda vetë Ministrisë. **Zgjidhja:** Qasja objektive dhe qëllimi i hartimit të ligjeve funksionale

- Koordinim dhe bashkëpunim jo i mjaftueshëm në mes të ministrive gjatë hartimit të ligjeve. **Zgjidhja:** Shqyrtimi dhe analizimi i akteve ligjore që ndërlidhën me ligjin në procedurë

- Zbatim jo i mjaftueshëm i ligjeve dhe akteve ligjore. **Zgjidhja:** Forcimi i rolit të institucioneve monitoruese, kontrolluese dhe inspektuese.

- Kundërshtim i ligjeve me ligjet e ministrive të ndërlidhura, veçanërisht me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe Ministrinë e Zhvillimit Ekonomikë (MZHE). **Zgjidhja:** Harmonizimi i qëndrimeve dhe arritja e konsensusit.

- Paqartësi në vendosjen e objektivave dhe reflektimit të tyre në zbatimin e ligjit. **Zgjidhja:** Caktimi i objektivave të qarta ligjore.

Nga se u shkrua më lart mund të thuhet se në Kosovë ekziston obligimi ligjor i harmonizimit të ligjeve me aktet ligjore të BE-së dhe përafrimin me *Acquis Cmmunautaire*, por në këtë drejtim mendoj se duhet bërë më shumë. Vlen të përmendën vetëm disa nga aktet ligjore të BE-së, dhe dokumente tjera, qëllimi i të cilave duhet të inkorporohej në Projekt Ligjin për Pyjet dhe ligje tjera në të ardhmen, si:

7. Aktet ligjore Ndërkombëtare

1. Marrëveshjet ndërkombëtare, konventat dhe protokollet, si: Kyoto, CBD, UNCCD, ITTO dhe Cites;

2. Programi Nacional i Pylltarisë (NFPs);

3. Natura 2000 dhe Pylli – Rezultat i rëndësishëm i BE-së në konservimin e biodiversitetit është implementimi i Natura 2000 dhe futja e direktivës së Zogjve dhe Habitave në kuadër të rrjetës Natura 2000 dhe promovimi i dispozitës së Pagesës të Shërbimit Mjedisor (PES) nëpërmjet të menaxhimit të pyjeve;

4. Prerjet ilegale/ Plani i Veprimit (Illegal logging/ FLEGTA ation plan;
5. Konferenca Ministrore mbi Mbrojtjen e Pyjeve në Evropë (MCPFE). Është forum politik i themeluar në vitin 1990 për dialog të çështjeve pyjore Evropiane;
6. Korniza e Konventës së (UNFCCC) (1992);
7. Konventa mbi diversitetin biologjik (2001);
8. Direktiva e BE no.409/70 mbi konservimin e zogjve të Egër;
9. Direktiva e BE no. 105/99 mbi tregun e materialit reprodaktiv pyjor (1999);
10. Direktiva e BE no.43/92 mbi mbrojtjen e habitateve , florës dhe faunës së egër (1992);
11. Direktiva e BE no. 2158 mbi mbrojtjen e pyjeve të BE nga zjarret pyjore (1992)
12. Direktiva e BE no.3528/86 mbi mbrojtjen e pyjeve të BE nga ndotja atmosferike (1986);
13. Direktiva e BE no.1615/89 mbi implementimin e sistemit informativ dhe komunikues për pyjet e Evropës (1989) dhe
14. Direktiva e BE no.89/68 në ligjin struktural të vendeve anëtare mbi lëndën e parë drusore (1968) etj.


8. Strukturat administrative dhe menaxhuese të pyjeve, tokave pyjore dhe kafshëve të egra

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është organi më i lart i administrimit dhe menaxhimit të pyjeve të pyjeve në Kosovë. MBPZHR bënë administrimin e pyjeve nëpërmjet D.P. dhe APK-ës.

8.1 Departamenti i Pylltarisë (DP)

Është njësi organizative në kuadër të MBPZHR, përgjegjëse për hartimin e politikave pyjore, hartimin e ligjeve dhe akteve nënligjore të menaxhimit të pyjeve dhe kafshëve të egra, ofrimin e këshillimeve dhe trajnimeve në pylltari dhe menaxhim të kafshëve të egra. DP. është përgjegjës, gjithashtu edhe për caktimin e rregullave të përgjithshme të menaxhimit dhe monitorimit dhe mbikëqyrjes së implementimit të njëjtave. Bënë azhurnimin e të dhënave në FisKos dhe azhurnimin e të dhënave tjera lidhur me sektorin e pylltarisë. Gjithashtu DP.[është përgjegjës për licencim të personave juridik dhe fizik, hartim të metodologjisë për plane menaxhuese afatgjatë dhe afatshkurta. Zhvillimi i projekteve financiare janë detyrë dhe përgjegjësi po ashtu e DP. Departamenti i Pylltarisë zhvillon dhe koordinon aktivitetet me ministri tjera.

Nr.1 Organigrami i Departamentit të Pylltarisë



Nga skema e larte shënuar shihet se DP. përbëhet prej katër divizioneve me numër të punëtorëve gjithsejtë 14.

Pikat e dobëta:

- Njësia organizative DP. nuk ka strukturë organizative krejtësisht të qartë dhe rol mirë të definuar. Kjo vërtetohet edhe në “ Strategji” fq. 7 ku në mes tjerash shkruan se DP. ka rol kontrollues/inspektues për operimet me qëllim të zbatimit të ligjeve, kurse praktikisht ky funksion është transferuar në APK-ës
- Numri jo i mjaftueshëm i stafit dhe në shpërprurje me strukturën organizative;
- Mungonë struktura drejtuese dhe përgjegjëse për pyjet private
- Mungojnë strukturatë drejtuese dhe staf përgjegjës për kullota;
- Mungon struktura drejtuese dhe staf përgjegjës për ndihmesë dhe orientim në marketingun e prodhimeve drunore dhe jo-drunore etj.

- Vlen të theksohet se është në procedurë aprovimi i Organigramit të ri.

8.2 Agjencia Pyjore e Kosovë (APK)

Është themeluar në bazë të Ligjit për Pyjet e Kosovës 2003/3 dhe aktet ligjore mbi themelimin e Agjencive Ekzekutive në Kosovë, vitin 2003. Është organ përgjegjës për menaxhimin të pyjeve dhe tokave pyjore publike dhe kontrollimin e menaxhimit të pyjeve private dhe menaxhim të pyjeve në parqet nacionale. Është përgjegjës gjithashtu edhe për zbatimin e akteve ligjore dhe akteve nënligjore që rregullojnë menaxhimin me pyje dhe toka pyjore.

8.2.1 Struktura e APK-ës

- Drejtoria e Administratës së Shërbimeve Qendrore;
- Drejtoritë Koordinuese të APK-së të vendosura në gjashtë qendra rajonale: Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Ferizaj dhe Gjilan.
- Drejtoria për Menaxhim të Pyjeve
- Drejtoria për Menaxhim të Kullotave, Kafshë të Egra, Gjueti dhe Ekoturizëm
- Drejtoria për Silvikulturë, Hulumtim dhe Prodhim Fidanor
- Zyra e Prokurimit

8.2.2 Përgjegjësitë kryesore¹²

- Implementon legjislacionin pyjor dhe UA të ndërlidhura me administrimin e pyjeve dhe tokave pyjore;
- Përmes inventarizimit, përcjell zhvillim e resurseve pyjore në Kosovë.
- Shqyrton kërkesat e paraqitura për dhënie e lejeve për prerjet dru-sore dhe jo-drusore, lëshon leje në pajtim me dispozitat në fuqi.
- Lëshon lejet për prerje,zgjedh dhe shënon trungjet për prerje, pranon punët e kryera dhe lëshon leje për transportin e drunjve.
- Lëshon leje për vjelje të prodhimeve jo-drusore.
- Kontrollon vendet e prerjes, deponimit, përpunimit si dhe transportin e masës drusore.
- Mbikëqyr dhe përcjell punët e prerjes dhe silvikulturës, për të siguruar përmbushjen e kërkesave të kontratës sipas lejeve, planeve vjetore operationale të menaxhimit me pyje sipas standardeve të punës.

¹² **Burimi:** Web faqja e MBPZHR

8.2.3 Drejtoria për Silvikultur, Hulumtim dhe prodhim Fidanor (Instituti i Pyjeve të Kosovës)

Kjo drejtori është e vendosur në Pejë dhe është përgjegjëse për:

- Përgatitjen e planeve vjetore për prodhimin e fidanëve pyjore;
- Përgatitja e planeve për pyllëzime dhe ripyllëzime;
- Grumbullimin e të dhënave me qëllim të hulumtimeve aplikative në pylltari;
- Identifikimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve pyjor dhe propozimin e masave për luftimin e tyre;
- Mbështetjen e trajnimeve, punëtorive dhe këshillimeve në lëmin e pylltarisë
- Mbështetjen dhe dhënien e këshillave profesionale gjatë hartimit të akteve ligjore , strategjive dhe programeve në sektorin e pylltarisë dhe menaxhimit të kafshëve të egra etj.


8.2.3.1 Pikat dobëta:

Kryesisht janë theksuar në ; “Dokumenti Politikat dhe Strategjia e Zhvillimit të Sektorit të Pylltarisë të Republikës së Kosovës, 2010-2020” , të cituar në faqen nëntë (9) në këtë dokument.

Propozim për evitimin e pikave të dobëta të punës së APK-ës:

- Shtimi i prerjeve ligjore dhe përmirësimi i vlerësimit të vlerës së drurëve në këmbë;
- Aplikimi efikas i lëshimit të lejeve për prerje dhe shfrytëzim të resurseve pyjore;
- Planifikimi i planeve vjetore të shfrytëzimit të pyjeve në sasi dhe cilësi në përputhje me kërkesat e popullatës dhe industrisë së drurit, pa çrregulluar balancën ekologjike dhe biologjike të pyjeve;
- Vlerësimi i trajtimit dhe rëndësisë së pyjeve të reja;
- Shfrytëzimi më racional i drurëve dhe mbetjeve drunore;
- Inventarizimi i sëmundjeve dhe dëmtuesve pyjor si dhe propozimi i masave për luftimin e tyre;
- Ndërmarrja e masave preventive në mbrojtjen nga zjarri si dhe monitorimi dhe kontrollimi;
- Ndarja e mandatit ekzekutiv nga mandati rregullativ, kontrollues dhe monitorues;
- Mbështetja e Njesisë për Silvikultur, Hulumtim dhe Prodhim fidanor dhe transformim në Institut kompetent për aplikimin e metodave dhe teknologjive të reja në pylltari;
- Harmonizimi i zhvillimit të pylltarisë me Industrinë e Drurit dhe anasjelltas dhe
- Shtimi i bashkëpunimit me pronarët e pyjeve private dhe shoqatat e pyjeve private.

Organogrami i Agjencisë Pyjore të Kosovës



9. Parimet e përgjithshme për Menaxhim të Qëndrueshëm të Pyjeve dhe Resurseve Pyjore

Kriteret: Mirëmbajtja dhe përmirësimi i institucioneve të përgjithshme dhe kushteve ekonomike për menaxhim të qëndrueshëm të pyjeve		
Kriteret	Indikatorët	Burimi u verifikimit
<p>Kriteri 1. Mirëmbajtja dhe përmirësimi i duhur i sipërfaqeve pyjore dhe tokës pyjore si dhe rritja e produktivitetit të tyre, funksionit mjedisor dhe social, duke pas në konsideratë pronën, llojet drunore, hapjen dhe qëllimin e pyjeve dhe tokës pyjore duke aplikuar metodën “ më afër natyrës” metodën e menaxhimit me pyje në përputhje me aktet ligjore, planet,dhe programet dhe standardet teknike</p>	<p>1.1 Sipërfaqja e pyjeve dhe tokave pyjore dhe ndërrimi i tyre krahasuar me gjendjen e më parshme</p> <p>a) Prona;</p> <p>b) Tipi i mbulesës pyjore (pyll, tokë pyjore, tokë e zhveshur, drurë jashtë pyllit);</p> <p>c) Qëllimi;</p> <p>ç) Origjina e pyjeve dhe</p> <p>d) Infrastruktura pyjore (mbritshmëria)</p>	<p>Inventarizimi i Pyjeve</p> <p>Plani zhvillimor i Pylltarisë</p> <p>Planet menaxhuese të pyjeve dhe</p> <p>Plani i pyllëzimeve.</p>
<p>Kriteri 2. Mirëmbajtja e shëndetit, stabilitetit biologjik, vitalitetit ,</p>	<p>2.1 Përqindja e pyjeve në të cilat praktikatat menaxhuese , mekanizmat natyror dhe proceset janë respektuar në nivel të</p>	<p>Inventarizimi i grumbujve pyjor;</p> <p>Librat e damkës pyjore</p> <p>Procesverbalet e</p>

<p>imunitetit të pyjeve duke aplikuar metodën e menaxhimit të pyjeve “ afër natyrës”, metodë e cila integron të dyja masatë at të silvikulturës dhe mbrojtjes preventive të pyjeve</p>	<p>Njësisë Menaxhuese (NjM)</p> <p>2.1.1 Zgjerimi i prerjeve sanitare me planet e rregullta të prerjes të prezantuara për vite në nivel të NjM.</p>	<p>komisioneve dhe inspektorëve</p> <p>Programet dhe raportet vjetore.</p>
<p>Kriteri 3. Mirëmbajtja dhe shtimi i funksionit prodhues të pyjeve duke përmirësuar hapjen e pyjeve në përputhje me kërkesat e natyrës, mundësit teknologjike, komerciale, rregulloret, programet dhe standardet teknike.</p>	<p>3.1 Hapja e rrugëve pyjore (m/ha) në krahasim me periudhën e shkuar të planifikuar, në nivel të NjM.</p> <p>3.2 Gjatësia dhe ndërrimet e mesatares së distancës së transportit dhe kosos mesatare të transportit të drurëve (për m³), krahasuar me periudhën e shkuar në nivel të NjM.</p> <p>3.3 Zgjerimi i infrastrukturës së re të prezantuar për origjinë pyjore dhe vite, në nivel të NjM.</p>	<p>Plani zhvillimor i Pylltarisë</p> <p>Raportet e komisioneve dhe mbikëqyrësve</p> <p>Plane vjetore etj</p>
<p>Kriteri 4. Ruajtja dhe rritja e përshtatshme e</p>	<p>4.1 Përqindja e sipërfaqeve të grumbujve pyjor dhe</p>	<p>Plani zhvillimor i Pylltarisë</p>

<p>diversitetit biologjik në ekosistemin pyjor duke përdorur metodën “ afër natyrës” të menaxhimit të pyjeve</p>	<p>përqindja e vëllimit të llojeve (specieve në grumbujt pyjor komercial duke respektuar pyjet natyrore the ndryshimet e tyre krahasuar me planifikimet e më pashme individual të përzier.</p>	<p>Raportet e komisioneve dhe mbikëqyrësve Plane vjetore etj.</p>
<p>Kriteri 5. Mirëmbajtja dhe shtimi përkatës i funksioneve mbrojtëse të pyllit nga erozioni i tokës dhe mbrojtja e ujërave sipas Kornizës të Vlerësimit Pan-Evropian për pyjet mbrojtëse dhe pyjet e mbrojtura</p>	<p>5.1 Përfshirja e këtyre pyjeve në inventarizim dhe bartja në hartë e këtyre funksioneve në nivel të rajonit pyjor dhe NjM. 5.2 Integrimi i kornizës mbrojtëse individuale në plan.</p>	<p>Harta e funksioneve pyjore Harta e qëllimeve pyjore Elaborati për deklarin e pyjeve mbrojtëse Plani menaxhues për Parqet Kombëtare Vlerësimi i ekspertëve për erozione dhe ujëra.</p>
<p>Kriteri 6. Mirëmbajtja dhe përmirësimi i funksioneve socio-ekonomike të pyjeve duke aplikuar administrim më efektive , rregullore dhe plane dhe programe efektive.</p>	<p>6.1 Ndarja e parcelave pyjore, sipas vjetëve, në nivelin lokal</p>	<p>Kadastra dhe dokumentacioni mbi pronën; Programi vjetor i menaxhimit; Kontrata mbi koncesionin; Raportet mujore dhe vjetore etj.</p>

<p>Kriteri 7. Mirëmbajtja dhe përmirësimi i kushteve të përgjithshme institucionale dhe ekonomike për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve.</p>		
<p>7.1 Sigurimi i aktiviteteve të përgjithshme administrative, planifikuese, profesionale dhe teknike dhe sigurimi i shërbimeve për të gjitha pyjet dhe funksionet pyjore në përputhje me aktet ligjore dhe programet.</p>	<p>7.1.1 Zgjerimi i këtyre aktiviteteve të Administratës Pyjore të cilat duhet të prezantohen sipas llojit të aktivitetit në të gjitha nivelet.</p>	<p>Raportet dhe programet vjetore të punës.</p>